



Protokoll

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

Maliq më, 02.08.2017

Nr. 4033 prot

KONTRATË

E lidhur sot në datë 02.08.2017 në Bashkinë Maliq midis palëve :

AUTORITETIT KONTRAKTOR : Bashkia Maliq përfaqësuar nga Kryetari i Bashkise Z.

Gëzim Topçiu, i quajtur më poshtë Autoriteti Kontraktor (investitor)

Adresa: Bulevardi "Rinia" Maliq

KONTRAKTUESI : Operatori ekonomik "Kacdedja" shpk, me NIPT K51712017A, përfaqësuar nga administratori Z. Skender Kacdedja, mbajtes i kartes se identitetit me Nr. F81118043W, të quajtur më poshtë (sipërmarrës).

Adresa: Tirane, Tirane, TIRANE, rruga Don Bosko, pallati Meld, kati i dyte

Neni 1
BAZA LIGJORE

1.1 Kjo kontratë do të zbatohet dhe interpretohet sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

1.2 Kjo kontratë hartohet në bazë të dispozitave ligjore të parashikuara nga Kodi Civil, Ligji Nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" (i ndryshuar) me ligjin Nr.182/2014, V.K.M. nr.914, datë 29.12.2015 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

1.3 Dokumentat Standarte të Tenderit, preventivi fitues dhe projekti janë pjesë përbërëse të kësaj kontrate.

Neni 2
Objekti i Kontratës

2.1 Kjo kontratë lidhet për realizimin e punimeve me objekt: "Reabilitim i shkollës 9-vjeçare Podgorie dhe rjetëzimi i terreneve sportive të shkollës, NJ.A., Vreshtas"

Neni 3
Vlera e Kontratës


3.1 Vlera e kontratës është :
20.395.270 (njezetmillion e treqindenentedhjetëepesemije e dyqindeshatedhjete) lek pa tvsh
24.474.324 (njezetekatermillion ekaterqindeshatedhjetekatermije etreqindenjezetekater) lek me tvsh

Neni 4

Afati

4.1 Afati kohor për ekzekutimin e kontratës është 3 (tre) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.
4.2 Për çdo ditë vonesë përtëj datës të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, Sipërmarrësi detyrohet të paguajë penalitetet në masën 0.01 % të vlerës së kontratës. Kjo vonesë do të bëhet si diferençë në situacionin përfundimtar.

Neni 5
Gjuha e Kontratës



Komunikimi

- 6.1 Komunikimi do të behet vetëm me shkrim në adresat respektive të seciles palë.
6.2 Në rast së do të ketë ndryshim të adresës palet kanë detyrimin të informojnë njera-tjetrën.

Neni 7 Afatet e Pagesës

- 7.1 Pagesa do të kryhet nga Autoriteti Kontraktor sipas situacioneve te paraqitura nga Kontraktuesin, në vlerën e përcaktuar në nenin 3(tre) të kësaj kontrate.

- 7.2 Pagesa do të kryet në lekë Shqiptare në llogarine bankare të operatorit "Kacdedja" shpk, tek Banka Kombëtare Tregtare me IBAN AL5020511014057731CLPRCLALLF

Neni 8

Detyrimet e investitorit

- 8.1 Lirimin e sheshit të ndërtimit në momentin e lidhjes së kontratës.
8.2 Investitori në bazë të pikes 18.1 dhe 33.5 te DST (Kushtet e përgjithshme të kontratës) mund të shtyjë afatin e përfundimit të punimeve pas kërkesës me shkrim nga sipërmarrësi.
8.3 Të kryeje pagesat sipas situacioneve të paraqitura nga sipërmarrësi duke mbajtur të pandryshuara çmimet e fitura në tender vetëm atëherë kur janë firmosur nga Drejtuesi i Punimeve.

Neni 9 Detyrimet e sipërmarrësit

- 9.1 Sipërmarrësi do të jetë përballë Investitorit tërësisht, teknikisht, administrativisht dhe juridikisht përgjegjës për zbatimin e punimeve sipas projektit dhe preventivit bashkëngjitur kësaj kontrate në përputhje të plotë të KTZ dhe ta dorëzojë objektin brenda afatit të përcaktuar në kontratë.
9.2 Sipërmarrësi nuk mund të ndryshojë zërat e punës të përcaktuara pa pëlqimin e Investitorit dhe Drejtorit të Punimeve e dhënë kjo me shkrim. Punimet e maskuara do të kryhen në përputhje me KTZ dhe do të shoqërohen me dokumentacionin përkatës të miratuar dhe firmosur nga Drejtuesi i Punimeve.
9.3 Të riparojë të metat e konstatuara nga Drejtuesi Punimeve brenda afatit të përcaktuar nga ai.
9.4 Të krijoje në dy kopie dosjen e objektit sipas kërkesave të drejtuesit të punimeve.

Neni 10 Praktikat e Korruptuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 10.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korruptuara. Veprimet e korruptuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 10.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në pergatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

- 10.3 Kontraktorët që lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve që emëruar nga Autoriteti Kontraktor.



Neni 11

Informacioni Konfidencial

11.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me konratën.

11.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontatës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në konratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premton ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 8.1 më sipër.

Neni 12 Prona Intelektuale

12.1 Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të konratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

12.2 Kontraktori, pas përfundimit të konratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të konratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënavë, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me konratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

12.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas konratës.

12.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i konratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas konratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 13 Origjina e Materialeve

13.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

13.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.

13.3 Për qëllime verifikimi "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së miaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është miaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

13.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 14 Vendimet e Drejtuesit të Projektit

14.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e konratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.



14.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përvèç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 15
Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

15.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me operatorin ne bashkepunim Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikun e realizimit te punimeve.

Neni 16
Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

16.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

16.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektoar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 17
Kontraktori që Kryen Punimet

17.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit, të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

17.2 Supervizori te inspekoje punimet. Puna nuk do te vazhdoje derisa Supervizori te kete aprovar një rrugëzgjidhje. Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vëne re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.

17.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të janë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë egzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standardeve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të janë aprovar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 18
Ekzekutimi i Punimeve

18.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë apo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të caktuar në nenin 4 (katër) të kësaj kontrate.

Neni 19
Ngritja e Kantierit

19.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.

19.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 20
Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

20.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktivitetave në kantier.



20.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike te rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 21
Raportimi i Grafikut të Zbatimit

21.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .

21.2 Në intervalle të skeduara rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

Neni 22
Paralajmërimi në Kohë

22.1 Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

Neni 23
Kontrolli i Cilësisë

23.1 Kontraktori do të jetë plotësish përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.

23.2 Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.

23.3 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

23.4 Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

Neni 24
Defektet e Pakorrigjuara

24.1 Nëse kontraktori nuk e ka korriguar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarise koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet. Dështimi për të korriguar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsyen mospërmbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.

Neni 25
Përgjegjësitë e kontraktorit

25.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 26
Sigurimi



26.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes ne kantier deri në afatin e realizimit të plote, në shumat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

26.2 Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e annulluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zgresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

26.3 Kushtet e siguracionit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktor.

**Neni 27
Testimet dhe Inspektimet**

27.1 Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e këruara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testimeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës.

27.2 Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose preqiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto testime dhe inspektime.

27.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë testime ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testimeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.

27.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të këruara në zbatimin e kontratës.

27.5 As ekzekutimi i testeve as inspektimi i punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

**Neni 28
Garancitë**

28.1 Kontraktori garanton se materialet e trupëzuar me punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.

28.2 Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë të Shqipëri.

**Neni 29
Kushtet e Pagesës**



29.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat paraprake, duhet të paguhën siç specifikohet në kontratë.

29.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet më një dispozitë tjeter në kontratë, pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë në ditën kur është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe i përcaktuar në kontratë.

29.3 Kontraktori ka të drejtë të marrë pagesa periodike gjatë progresit të zbatimit të projektit. Grafiku i pagesave periodike do të parashikohet në KVK. Kur bëhet një pagesë e parashikuar, kontraktori duhet të paraqese një deklarate me situacionin e muajit tek drejtesi i projektit ku deklaron se plani sipas grafikut është permbushur. Komunikata gjithashtu duhet të shprehë vlerën e punës së ekzekutuar duke hequr shumën e grumbulluar të verifikuar më parë, si dhe shumën e pagesës paraprake të papaguar dhe çdo shumë të mbajtur në pritje të korrigjimit të një defekti.

29.4 Drejtesi i projektit duhet të kontrollojë punimet e ekzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktorit, brenda 20 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtesi i projektit.

29.5 Pagesa e periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga drejtesi i projektit.

29.6 Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

Neni 30 Vonesa në Bërjen e Pagesës

30.1 Shperblimi per demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit te vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligji. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bërë llogaritja e tyre.

30.2 Kamata ligjore paguhet pa qene i detyruar kreditori (kontraktori) te provoje ndonje dem. Nëse kreditori (kontraktori) provon se ka pesuar një dem me të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktor) duhet të paguajë pjesën e mbetur të demit.

Neni 31 Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

31.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligji, irregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të irregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 32 Forca Madhore

32. Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit te kontratës, dëmova, ndërmëva, ndërmëvësim, ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim është. Nuk mund të dështim tjetër në përbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pësosje e Shqipërisë, import-export, tregtarie, Forca Madhore.



32.2 Për qëllimet e këtij nenit "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

32.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Blerësin Publik. Me përashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 33 Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

33.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

33.2 Me përashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet përvonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit së Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.

33.3 Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

33.4 Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.

33.5 Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrëthana të tjera nëse është në interesin publik përvonesën. Ne rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim përvonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

Neni 34 Dëmet e Likuidueshme përvonesën në Mbarimin e Punimeve

34.1 Dëmet e likuidueshme përvonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

- a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 35 Negociatat dhe Amendamentet

35.1 Palët fushatës negocionë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së kontraktorit. CEDJA, Shpk IMPORT EXPORT ALBANIA



35.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqsues i autorizuar i kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor.

35.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqsues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 36
Ndryshimi i Porosisë

36.1 Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegocimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

36.2 Ndertime shtesë mund të porositen vetëm në rethana të përcaktuar në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit origjinal të kontratës.

36.3 Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosissë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:

- a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
- b) Korrigjime në materiale
- c) Korrigjime në sasi

36.4 Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort pér çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materilizojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime pér pajtimin me ndryshimin e porositur përvèç irregullimeve të siguruara në amendamentet e marrveshjes.

36.5 Materilaet egzistuese dhe materilaet që do të hiqen në objektet që do të riparohen janë në pronësi të Autoritetit Kontraktor.


Neni 37
Preventivi pér Njësi ose në Total

37.1 Kontrata do të përfshijë një Preventiv në Total nëse është një kontratë me shumë totale ose një Preventiv pér Njësi nëse është një kontratë me çmim njësie. Nëse është një kontratë me çmim njësie, preventivi pér njësi do të përbajë volumet e zérave të ndërtimit, instalimin, testimin dhe komisionet që bëhen nga kontraktori.

37.2 Preventivi pér Njësi do të përdoret pér të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktori do të paguhet pér sasinë e realizuar me tarifën në preventivin në njësi pér secilin zë punimesh.

Neni 38
Mbarimi dhe marrja përsipër e ndërtimeve

38.1 Kontraktori duhet të kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikat pér mbarimin e punimeve dhe drejtuesi i projektit do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se punimet janë mbardar përfunduar.



38.2 Nëse drejtuesi i projektit zbulon se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japi udhezime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zerat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.

38.3 Nëse drejtuesi i projektit zbulon defekte në Punime, drejtuesi i projektit duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigohen para se të lëshohet certifikata.

Neni 39
Ndërprerja për Mosplotësim

39.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjeter të kontratës.

39.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

39.3 Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoriteti Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim te kushteve te saj.

Neni 40
Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

40.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

40.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 41
Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

41.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

41.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

41.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin për të gjitha Punët e pranuara dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 42
Transferimi i të Drejtave

42.1 Kontraktori duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës së përjashtim kur jepë miratimi paraprak nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 43



Sigurimi i Kontratës

43.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet ti dorëzojë Autoriteti Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar.

43.2 Shuma e sigurimit te kontrates duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktori në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

43.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit do të mbahet deri në përbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.

Neni 44

Nënkontraktimi

44.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë.

44.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontraktojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacinin që provon aftësinë e nën-kontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

44.3 Cdo nenkontraktor duhet te kete te drejte te marre pjese ne prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkete tek nënkontraktori për punët që do të kryejë

44.4 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pavarësisht nga sjellja e nenkontraktorit.

Neni 45

Zgjidhja e Kontratës

45.1 Zgjidhja e kësaj kontrate do të bëhet kur ka përfunduar afati i përmendur në nenin 4 (katër) të kësaj kontrate.

a. Kontrata zgjidhet dhe në rastet kur :

- Sipërmrresi ndalon punimet për 10 ditë rresht pa arsy e dhe nuk parashikohet në programin e punimeve të miratuar dhe kur ndalimi nuk është autorizuar nga Investitori apo Drejtori i Punimeve.
- Sipërmrresi falimenton dhe fillon likujdimet, keqpërdor fondet .

b. Në keto raste likujdimi i punimeve do të bëhet konform kushteve të përgjithëshme dhe të veçanta të kontrates.


Neni 46

Garancia e Difekteve

46.1 Periudha e Garancisë së Difekteve do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj pas përfundimit të punimeve (akt-kolaudit). Shuma e garancisë së mbajtur për efekt të Garancisë së Difekteve do të jetë në masën 5% të vlerës së Kontratës dhe do të bëhet nga situacionët pjesore në mënyrë proporcional me vlerën e situacionit dhe do të lirohet në fund të periudhës të Garancisë së Difekteve.

Neni 47

Zgjidhja e Mosmarveshjeve



- 47.1 Palët duhet të bëjnë çdo përpjekje për të zgjidhur mosmarreveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre në lidhje me këtë kontratë.
- 47.2 Nëse palet dështojnë në zgjidhen e mosmarreveshjeve ose konflikteve, secila nga palet mund t'i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për zgjidhen e mosmarreveshjeve.

Kjo kontratë u hartua në 5 (pese) kopje duke u firmosur prej paleve në cdo flete. Nje kopje e kontrates ju dorëzua Kontraktuesit dhe 4 (kater) kopje qëndrojnë në Bashkinë Maliq.

INVESTITORI

BASHKIA MALIQ

Përfaqësuar nga:

Kryetari i Bashkisë

Z.Gëzim TOPÇIU



SIPËRMARËSI

**OPERATORI EKONOMIK
“KACDEDJA” shpk**

Përfaqësuar nga:

